



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 583 Prot

Tiranë, më 14.09.2020

V E N D I M

Nr.91, datë 14.09.2020

Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me shkresën nr. 581 prot., datë 02.07.2020 dhe nr. 583, datë 03.07.2020, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në zhvillimin e procedurave të konkurrimit të publikuara me shpallje nr. 2946, nr. 2956 dhe nr. 2977

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të përcjellë prej kërkuesve ***** dhe *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesave të regjistruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 581 prot., datë 02.07.2020 dhe nr. 583 prot., datë 03.07.2020, kërkuesit ***** dhe ***** , kanë ngritur pretendimin se njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, gjatë kryerjes së procedurave të konkurrimit të publikuara me numër #2956, #2956 dhe #2977, të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil pranë Autoritetit të Aviacionit Civil.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, në zbatim të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020, njësia përgjegjëse (DAP) ka publikuar në portalin e saj shpalljet për procedurat e konkurrimit si më poshtë:

1. Shpallja nr. **2946**, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë*”, në Autoritetin e Aviacionit Civil - kategoria e pagës III-a;
2. Shpallja nr. **2956**, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve*”, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Autoritetin e Aviacionit Civil – kategoria e pagës III-a;
3. Shpallja nr. **2977**, për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve “*Inspektor*”, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Operimit të Aeroporteve, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Aeroporteve, në Autoritetin e Aviacionit Civil – kategoria e pagës III-b.

Nga verifikimi “*online*”, konstatohet se, për të gjitha konkurrimet e mësipërme njësia përgjegjëse ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë të kualifikuar. Për këtë arsye dhe në zbatim të nenit 22, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar vijimin e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë (*për konkurrimet me numër shpallje #2946 dhe #2956*) dhe pranimin në shërbimin civil (*për konkurrimin me numër shpallje #2977*).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se me vendimin nr. 13, datë 09.07.2020, të Departamentit të Administratës Publike, është vendosur pezullimi i procedurës së ngritjes në detyrë për konkurrimet me numër shpallje **#2946** dhe **#2956**. Në përmbajtje të këtij vendimi, njësia përgjegjëse parashtron si shkak pezullimi, fillimin e hetimit administrativ për shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura prej ankuesit *****.

Në lidhje me dy konkurrimet e mësipërme, ankuesi ***** ka pretenduar se njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për fazën e ngritjes në detyrë, për shkaqe si më poshtë:

- a- Për procedurën e konkurrimit nr. 2946, në të cilën rezulton të jetë kualifikuar kandidati ***** , pretendohet se përzgjedhja e këtij kandidati është kryer në kundërshtim me ligjin, pasi ai ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo për faktin se, pozicioni i punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë*”, për të cilin ky kandidat konkurren është përgjegjës për auditimin e drejtorive apo sektoreve të Autoritetit të Aviacionit Civil, ku në njërin prej tyre rezulton se ushtron detyrën bashkëshortja e tij (*bëhet fjalë për nëpunësen ***** , emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Mbikëqyrjes së Sigurisë në Transportin Ajror, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion*);

b- Për procedurën e konkurrimit nr. 2956, pretendohet se, njësia përgjegjëse në aktin e shpalljes ka vendosur kriteret të posaçme të ndryshme nga ato që janë miratuar nga Bordi Mbikëqyrës i Autoritetit të Aviacionit Civil. Konkretisht, parashtrohet se kriteri i përvojës së punës është ndryshuar nga *“3 vite përvojë pune në planifikime buxhetore ose prokurime”* në *“...të paktën 3 vite përvojë punë në profesion, nga të cilat të paktën 1 vit në prokurime publike”*. Ndryshimi i kriterëve të posaçme në lidhje me përvojën e punës ka sjellë si pasojë kualifikimin e paligjshëm të kandidatës *****.

Njëkohësisht, rezulton se, për procedurën e konkurrimit me numër shpallje #2946, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është depozituar ankesa prej kërkuesit *****, i cili pretendon se, njësia përgjegjëse ka shkelur përcaktimet e nenit 4 dhe 5, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, duke favorizuar përzgjedhjen e kandidatit ***** , për procedurën e ngritjes në detyrë, edhe pse rezulton të jetë i përfshirë në interesave private.

Nga ana tjetër, konstatohet se, për shkak të ankesës së paraqitur prej kërkuesit ***** , si dhe për shkak të hetimit administrativ të filluar nga Komisioneri, njësia përgjegjëse ka pezulluar procedurën e pranimit në shërbimin civil për konkurrimin me numër shpallje #2977.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 18, datë 21.07.2020, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për pezullimin e procedurës së pranimit në shërbimin civil të shpallur me kodin nr. #2977 – Lloji i diplomës “Inxhinieri Elektronike/Inxhinieri Mekanike”, niveli i diplomës “Master profesional”*, vërehet se kërkuesi ***** ka pretenduar se, njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit për shërbimin civil, duke kualifikuar për fazën e pranimit në shërbimin civil kandidatin *****.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga njësia përgjegjëse (*dokumentacion i cili administrohet në sistemin HRMIS*), rezulton se kandidati ***** ka qenë nëpunës civil i emëruar në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Operimit të Aeroporteve, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Aeroporteve, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil. Gjatë ushtrimit të detyrës, për këtë nëpunës, me vendimin nr. 22, datë 24.12.2018, të Komisionit Disiplinor, është vendosur marrja e masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”*.

Më pas, në zbatim të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, ky nëpunës ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga detyra, e cila rezulton të jetë miratuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil me aktin nr. 987 prot., datë 17.05.2019, *“Lirim nga shërbimi civil”*.

Në referencë të rrethanave të paraqitura sa më sipër, kërkuesi ***** ka pretenduar se kandidati ***** është favorizuar në mënyrë të paligjshme nga njësia përgjegjëse, duke u kualifikuar për të vijuar me tëj me fazën e konkurrimit nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, në kushtet kur konstatohet se ndaj këtij kandidati ka një masë disiplinore në fuqi.

Duke analizuar gjithë sa u parashtrua më sipër, ku përfshihen pretendimet e ankuesve ***** dhe *****, dokumentacioni i dërguar nga njësia përgjegjëse, si dhe aktet e tjera të publikuara në portalin e DAP, arrihet në përfundimin se verifikimi paraprak i procedurës së ngritjes në detyrë (*konkurrimi nr. 2946 dhe nr. 2956*) dhe i pranimit në shërbimin civil (*konkurrimi nr. 2977*) është kryer në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për arsyet do të parashtrohen në vijim.

Së pari, në lidhje me pretendimin se, kualifikimi i kandidatit ***** për procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë*”, në Autoritetin e Aviacionit Civil, është kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi me arsyetimin se, ky kandidat ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, nuk qëndron për arsyet si më poshtë:

Me qëllim parandalimin e konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta, në ligjin nr. 9367, datë 07.05.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, janë përcaktuar shprehimisht rregullat, mjetet, mënyrat dhe procedurat që duhet të zbatohen për identifikimin, deklarin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit. Ky ligj, në përmbajtje të tij, përcakton jo vetëm përkufizimin e konfliktit të interesit, por njëkohësisht edhe llojet e ndryshme të shfaqjes së tij.

Ndërkohë, ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka përcaktuar si shkak që pengon ushtrimin e detyrës së nëpunësit civil vetëm ***situatën e konfliktit të vazhdueshëm të interesit***, e cila sipas neni 3, pika 4, germa d), të ligjit nr. 9367, datë 07.05.2005, nënkupton ***gjendjen në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.***

Nëse ky konflikt interesi, deklarohet nga vetë nëpunësi civil ose nga persona të tjera, dhe konstatohet si i tillë, ligji për shërbimin civil përcakton si mjet të shmangies së këtij konflikti, transferimin e detyrueshëm të nëpunësit në një pozicion tjetër të shërbimit civil (neni 52), si dhe largimin nga shërbimi civil, në rastet kur nëpunësi nuk merr masat për shmangien e konfliktit të interesit apo nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk menjanon gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit (neni 66, pika d)

Referuar pretendimeve të paraqitura në përmbajtje të të dy ankesave, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se konflikti i interesit në rastin e nëpunësit ***** , mund të klasifikohet si *konflikt në dukje i interesit ose konflikt i mundshëm i interesit*, të cilat sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil, nuk përbëjnë shkak ligjor për moskualifikimin e këtij kandidati në procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, me arsyetimin se bashkëshorjtja e këtij kandidati aktualisht ushtron detyrën në pozicionin të nivelit të ulët drejtues, brenda të njëjtit institucion.

Për më tepër, në nenin 6, të ligjit nr. 9367, datë 07.05.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, verëhet se detyrimi ligjor i konstatimit, verifikimit dhe parandalimit të çdo konflikti të interesit lind vetëm pas zgjedhjes ose emërimit të zyrtarit dhe në vazhdim të ushtrimit të detyrës së tij. Kjo nënkupton se, në rastin e konkret, kandidatët pjesmarrës në procedurat e rekrutimit, nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë ose pranimit në shërbimin civil nuk mund të s’kualifikohen gjatë verifikimit paraprak, me pretendimin se ndaj tij ekziston rreziku i mundshëm i konfliktit të interesit.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e ankuesit ***** se, njësia përgjegjëse (DAP), në kundërshtim me vendimmarrjen e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil ka ndryshuar kriteret e posaçme për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve*”, publikuar me numër shpallje #2977, sqarojmë si më poshtë:

Autoriteti i Aviacionit Civil ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “*Për Autoritetin e Aviacionit Civil*”, i ndryshuar, i cili në nenin 6 të tij është përcaktuar se: “*Këshilli Mbikëqyrës... miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet specifike dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe sektorëve, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil*”.

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, përcakton procedurën që duhet të ndiqet në lidhje me miratimin e përshkrimeve të punës. Konkretisht për institucionet e administratës shtetërore, ky proces kërkon bashkërendimin e punëve midis analistit, eprorëve direkt të pozicionit respektiv të punës dhe Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë, i cili miraton këto akte. Më tej, është njësia përgjegjëse (DAP) e cila finalizon këtë procedurë nëpërmjet miratimit të përshkrimeve ose mund të kthejë për rishkim përshkrimet, në rast se vëren se këto akte nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij hetimi, konstatohet se, përshkrimi i punës në rastin e pozicionit “*Përgjegjës i Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve*”, në Autoritetin e Aviacionit Civil është i nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, fakt që

përcakton se është respektuar procedura e mësipërme. Në këto kushte, arrihet në konkluzionin se, procedura e konkurrimit me numër shpallje #2956 është kryer në përputhje me dispozitat ligjore, fakt që passjell se dhe kualifikimi i kandidates ***** është kryer në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të publikuara në aktin e shpalljes.

Së treti, në lidhje me pretendimin e ankuesit ***** se, njësia përgjegjëse ka zbatuar gabim ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procedurës së konkurrimit me numër shpallje #2977, pasi ka favorizuar në mënyrë të paligjshme kandidatin ***** , duke vendosur kualifikimin e tij për të vijuar me procedurën e konkurrimit nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, parashtrijmë sa më poshtë:

Në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohen në mënyrë eksplicite kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për pranimin në shërbimin civil, ku ndër të tjera përmendet:

- “ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji”.

Nga sa është parashtruar më sipër, rezulton se ndaj këtij nëpunësi nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, por se marrëdhënia e tij në shërbimin civil ka përfunduar për shkak të ushtrimit të së drejtës së tij të përcaktuar në nenin 64, të ligjit për shërbimin civil, konkretisht nëpërmjet dhënies së dorëheqjes.

Në rastin konkret pretendohet se, masa disiplinore e dhënë ndaj kandidatit ***** , përbën një pengesë për pjesëmarrjen e tij në procedurat e konkurrimit nëpërmjet pranimit në shërbimin civil. Kjo për faktin se, në kuptim të nenit 64, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Për shkak të përcaktimit të mësipërm ligjor, ankuesi pretendon se, kandidati ***** vazhdon të gëzojë disa të drejta të nëpunësit civil deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të dhënies së dorëheqjes, të drejta të cilat aktualisht nuk mund t’i ushtrojë për shkak se ndaj tij ekziston një masë disiplinore në fuqi, e cila përbën një nga kriteret e përgjithshme të skualifikimit për procedurën e lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.

Në vlerësim të kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien në shërbimin civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se, e drejta e përcaktuar në nenin 64, germa 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar është një e **drejtë extra**, që

legjislatori u mundëson nëpunësve të larguar nga shërbimi civil për shkak të dhënies dorëheqje. Por nga ana tjetër, njohja e kësaj të drejtë, nuk ndalon ose kufizon nëpunësit që të rifuten në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së pranimit në nivelin ekzekutiv, nëse rezulton se plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 21, të ligjit të sipërcituar, si dhe kriteret e posaçme të pozicionit të punës.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se pretendimi i ankuesve ***** dhe *****, për paligjshmëri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit me numër shpallje #2946, #2956 dhe #2977, është i padrejtë.

Në kushtet e mësipërme, njësia përgjegjëse duhet të marrë masa për të vijuar procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë me numër shpallje #2946 dhe #2956, si dhe procedurën e pranimit në shërbimin civil me numër shpallje #2977, duke hequr pezullimin e vendosur respektivisht me vendimin nr. 13, datë 09.07.2020 dhe nr. 18, datë 21.07.2020.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesave nr. 581 prot., datë 02.07.2020 dhe nr. 583, datë 03.07.2020, të shtetasve ***** dhe *****, pasi nuk janë evidentuar parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurave të konkurrimit të publikuara me numër shpallje #2946, #2956 dhe #2977, të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil pranë Autoritetit të Aviacionit Civil.
2. Departamenti i Administratës Publike të vijojë procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, të publikuar me numër shpallje #2946 dhe #2956, duke hequr pezullimin e vendosur me vendimin nr. 13, datë 09.07.2020.
3. Departamenti i Administratës Publike të vijojë procedurën e konkurrimit nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, të publikuar me numër shpallje #2977, duke hequr pezullimin e vendosur me vendimin nr. 18, datë 21.07.2020.

4. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesit ***** dhe *****.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha